Dorëshkrim për Orientimin e Vullnetarëve (Seminar në Internet -Webinar)

TREGUESI 1

Përshëndetje! Ju falenderojmë për vullnetarizmin tuaj në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias. Ne j'u jemi shumë mirënjohës për kohën dhe talentin tuaj në shërbim të nxënësve tanë.

TREGUESI 2

Në këtë paraqitje ne do të shpalosim bazat e vullnetarizmit në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, në mënyrë, që ju të jeni të gatshëm menjëherë që të filloni punën vullnetare.

Fillimisht ne do të japim një përshkrim se kush jemi ne si organizatë, përfshirë një përshkrim të vlerave tona dhe një informacion demografik. Më tutje, ne do t'ju tregojmë përse vulletarët si ju janë aq të rëndësishëm për suksesin e nxenësve tanë.

Pjesa tjetër e orientimit do të fokusohet në detajet praktike të dokumentacionit të kërkuar për një të rritur, i cili do të punojë vullnetar në ndërtesat tona. Ne do të flasim se çfarë është Kodi i Sjelljes së Vullnetarit, bashkë me dokumentat që kërkohen dhe rrugët për marrjen e tyre. Ne do të trajtojmë rëndësinë e masave të sigurisë në lidhje me abuzimin ndaj fëmijës. Nga fundi i këtij orientimi, ju do të mësoni se si të dalloni shënjat e abuzimit ndaj fëmijës dhe hapat e duhura për raportimin e një abuzimi të mundshëm.

Në fund të orientimit do të keni një test të shkurtër, i cili do të provojë njohuritë e fituara në këtë orientim.

TREGUESI 3

Qëllimi i Orientimit është përgatitja juaj për vullnetarizëm në shkollat tona. Me përfundimin e këtij trajnimi ju do të kuptoni nevojat e shkollave tona dhe se sa e rëndësishme është puna vullnetare në plotësimin e këtyre nevojave; ju do të kuptoni përbërësit e Paketës së Vullnetarit dhe se si t'a plotësoni këtë paketë; ju do të ndjeheni besimplotë se si të veproni gjatë vullnetarizmit në shkollën tuaj;ju do të kuptoni se jeni një raportues i mandatuar dhe çfarë nënkupton kjo gjë; ju do të jeni në gjëndje të identifikoni shënjat e abuzimit me fëmijët dhe hapat që ndërmerren si përgjigje ndaj saj; dhe, sëfundi ju do të ndjeheni i ngazëllyer për vullnetarizmin në shkollën tuaj!

TREGUESI 4

Le të fillojmë se kush jemi ne si organizatë dhe drejtori arsimore.

TREGUESI 5

Drejtoria Arsimore e Filadelfias është e bazuar në katër vlera kryesore: që të gjithë nxënësit mundet dhe do të mësojnë; që mësimdhënia me cilësi të lartë është në bazën e të gjithë punës tonë; që prindërit dhe familjet janë partnerët tanë dhe që ne jemi kujdestarët e besuar të burimeve publike.

TREGUESI 6

E gjithë puna jonë synon të plotësojë vizionin e madh të mëposhtëm: Për të gjithë fëmijët, aty afër ku ata jetojnë, të kemi një shkollë e shkëlqyer.

TREGUESI 7

Synimet tona kryesore na mbajnë të përqëndruar në arritjen e këtij vizioni. Çdo ditë mësuesit tanë, drejtorët, personeli mbështetës dhe administratorët janë duke punuar drejt synimeve të mëposhtëme:

100% e nxënësve do të diplomohen, të jenë gati për kolegj, ose karrierë,
100% e fëmijëve të moshës 8-vjeçare do të lexojnë në nivelin e klasës,
100% e shkollave do të kenë mësues dhe drejtorë të dalluar, dhe
Ne do të kemi 100% të fondeve të nevojshme për shkolla pararojë dhe zero defiçit.

TREGUESI 8

Sëbashku ne i shërbejmë më shumë se 130,000 nxënësve. Nxënësit tanë vijnë nga një gamë e gjërë prejardhjeje dhe përvojash- diçka me të cilën ne krenohemi. Ne kemi 220 shkolla, me më shumë se 17,000 të punësuar. Çdo shkollë është unike dhe ka pikat e forta dhe nevojat specifike të saj.

TREGUESI 9

Me kaq shumë shkolla dhe një trupe nxënësish kaq të ndryshme, ne mbështetemi në vullnetarët që ndihmojnë personelin tonë për të ofruar mundësitë dhe edukimin më të mirë të mundshëm për nxënësit tanë.

TREGUESI 10

Ne varemi nga puna vullnetare që të ndihmojmë rritjen e nxënësve, që të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Rritja e gjeneratës së ardhshme është një përgjegjësi e ndarë, ku të gjithë kanë vendin e tyre.

TREGUESI 11

Sigurisht është e thjeshtë që të ndjehesh skeptik për pjesën që ju — një vullnetar individual — mund të luani në jetën e nxënësve tanë, por a keni dëgjuar ndonjëherë për historinë e yllit të detit? Historia është kështu:

> Një ditë një djalosh po ecte gjatë bregut të detit dhe pa një plak që po hidhte në ujë njëri pas tjetrit shumë yje deti , që kishin dalë në breg. Yjet e detit i kishte lënë dallga në breg dhe me siguri ata do të ngordhnin nën rrezet e diellit, nëse nuk i hidhnin përsëri në ujë.
>
> Plaku vazhdonte pa u lodhur punën e tij, pavarësisht se ishin qindra- në mos mijra- yje deti në breg, të cilat i hidhte përsëri në det.
>
> Djaloshi e pa dhe tundi kokën. “Ti kurrë nuk do të mundësh t’i shpëtosh të gjithë ata,” i tha ai plakut. “Pse lodhesh kot? Kjo s’ka kuptim.”
>
> Plaku vështroi djaloshin dhe pastaj hodhi edhe një tjetër yll deti në ujë dhe tha “Kjo ka kuptim për këtë” dhe vazhdoi punën e tij.

Morali i fabulës së kësaj historie është se fakti që një njeri i vetëm nuk mund të shpëtojë botën, kjo s'do të thotë që nuk ka kuptim që të mos kërkojë të veprojë. Çdo kontribut që ju bëni, mund të ndihmojë që të bëjë ndryshimin, s'ka rëndësi se sa i vogël është ai. Ju kurrë nuk mund të dini impaktin që mund të keni tek të tjerët.

TREGUESI 12

Tani që ju dini diçka më shumë për Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, shpresojmë të ndjeheni të frymëzuar dhe të gatshëm për vullnetarizëm!

Përpara se të filloni, është edhe një hap i madh përpara që duhet t'a kaloni. Ajo që po flasim ka të bëjë me shkresat e kërkuara. Po mos u shqetësoni! Ne do të trajtojmë çdo shkresë që ju duhet, si duhet t'a merrni atë, në mënyrë që ju të filloni vullnetarizmin sa më shpejt, që të jetë e mundur!

TREGUESI 13

Duke filluar nga viti shkollor 2017-2018, të gjithë të rriturit që dëshirojnë të punojnë vullnetarisht në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, duhet të plotësojnë dhe dërgojnë në shkollën e tyre Paketën e Vullnetarit. Paketa e Vullnetarit do të përfshijë të gjitha shkresat, të cilët duhen plotësuar nga individët përpara se të fillojnë punën vullnetare. Duke i sjellë të gjitha shkresat në një paketë, drejtori juaj do të jetë në gjendje të shikojë çertifikatat e kërkuara të pastërtisë dhe do të kontrollojë plotësimin e të gjitha shkresave, të cilat do të mundësojnë fillimin e vullnetarizmit sa më shpejt!

Paketa e Vullnetarit duhet të përfshijë përbërësit e mëposhtëm:

Marrëveshja e Kodit të Sjelljes së Vullnetarit
Historia e Pastërtisë ndaj Abuzimit me Fëmijët
Kontrolli i Rekordeve Kriminale të Shtetit të Pensilvanisë
Kontrolli i Dokumentacionit të FBI, OSE një Formular i Firmosur i Vërtetimit të Vullnetarit dhe Një Çertifikatë për Plotësimin e Orientimit për Vullnetar — të cilën ju do ta merrni me plotësimin e këtij trajnimi!

Në seksionet e ardhshme, ne do të mësojmë si të kemi akses dhe të plotësojmë të gjitha këto dokumentacione.

TREGUESI 14

Ju mund të pyesni, " A duhet që çdonjeri që futet në shkollë të plotësojë Paketën e Vullnetarit?" Përgjigja e shkurtër është -jo. Vetëm të rriturit- njerëzit 18 vjeç dhe më shumë — të cilët janë në shkollë si *vullnetarë* duhet të plotësojnë Paketën e Vullnetarit. Të rriturit, të cilët janë *vizitorë* në shkollë, NUK kanë nevojë të kenë Paketën e Vullnetarit.

Drejtoria Arsimore e Filadelfias bën dallim midis "vullnetarëve" dhe "vizitorëve." Vizitorë" konsiderohen ata individë, të cilët ndjekin dhe/ose vështrojnë një takim, ose aktivitet pa ofruar shërbime për nxënësit, personelin, veprimtarinë e shkollës, ose drejtorisë dhe të cilët nuk janë përgjegjës për kujdesin, mbikëqyrjen, drejtimin, ose kontrollin e fëmijëve. Disa shëmbuj të këtyre aktiviteteve mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në: Netët Përsëri-në-Shkollë, takimet prind/mësues, mbledhjet e shkollës, koncertet e shkollës dhe paradat e Halloween_it.

“Vullnetarët” janë të përcaktuar si të rritur, të cilët aplikojnë për një pozicion që nuk paguhet në një shkollë ose program, aktivitet, shërbim, ose një person përgjegjës për mirëqenien e fëmijës, ose që ka kontakt të drejtëpërdrejtë me fëmijët. Shëmbujt mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në: Tutorë ose mentorë; pjestarë të Këshillit Konsultativ të Shkollës, Shoqata Familja dhe Shkolla, ose Shoqata Prind Mësues; ndihmës në Bibliotekë; ndihmës në hyrjen e shkollës; ndihmës në takime fëmijësh, ose shoqërues në ekskursione.

TREGUESI 15

Me plotësimin e të gjithë dokumentacionit, ju duhet të sillni në sekretarinë e shkollës Paketën e plotësuar të Vullnetarit, e cila e kalon atë për rishikim tek drejtori, ose Koordinatori i Vullnetarëve.

Pas rishikimit e gjitha kjo ruhet në një vend të sigurtë.

Me firmosjen e Marrëveshjes për Kodin e Sjelljes të Vullnetarit nga ana e drejtorit, ju mund të filloni punën vullnetare!

TREGUESI 16

Ne e dimë që gjithë këto dokumentacione janë një ngarkesë e madhe dhe humje kohe. Lajm i mirë është se Paketa juaj e Vullnetarit do të jetë e vlefshme për 60 muaj, ose 5 vjet nga dita që ju keni marrë çertifikatën tuaj të pastërtisë! Kjo do të thotë që ju NUK do të keni nevojë të merrni çdo vit të ri shkollor, një Paketë të re të Vullnetarit, ose Orientim për Vullnetarët.

Plus: Nëse ju dëshironi të jeni vullnetar në një shkollë tjetër, ose nëse fëmija juaj ndryshon shkollën ekzistuese, ju mund të përdorni Paketën ekzistuese të Vullnetarit në shkollën e re (nëse dokumentacioni është më pak se 60 muaj). Vetëm firmosni Kodin e Sjelljes së Vullnetarit merrni miratimin e drejtorit dhe ju jeni gati të punoni si vullnetar!

TREGUESI 17

Përbërësi i parë i Paketës së Vullnetarit është Kodi i Sjelljes së Vullnetarit.

TREGUESI 18

Qëllimi i Kodit të Sjelljes së Vullnetarit është të spjegojë pritshmëritë dhe standardet për vullnetarizmin në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias. Kodi i Sjelljes të Vullnetarit përgjithëson sjelljen standarde, profesionalizmin dhe respektin që të gjithë vullnetarët duhet të manifestojnë kur janë në shkollat tona. Të gjithë vullnetarët duhet të lexojnë, miratojnë dhe firmosin Kodin e Sjelljes së Vullnetarit përpara se të jenë vullnetarë në shkollat e drejtorisë Arsimore të Filadelfias.

Me firmosjen e Kodit të Sjelljes së Vullnetarit, vullnetarët pajtohen të ndjekin standardet e mëposhtëme:

- Unë do të firmos në zyrën e sekretarisë së shkollës, posa të arrij në shkollë.
- Unë do të ndjek udhëzimet e administratorit të shkollës, mësuesve dhe/ose të pjestarëve të caktuar të shkollës.

- Unë pajtohem që të sillem gjatë gjithë kohës në mënyrë profesionale dhe të respektueshme. Unë e kuptoj që vullnetarët janë modele për nxënësit dhe do të sillem në mënyrë të tillë, gjatë gjithë kohës.
- Unë e kuptoj që unë kam përgjegjësi për ndjekjen e politikave dhe proçedurave të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. Unë e kuptoj që SDP ka një përkushtim të madh ndaj diversitetit dhe përfshirjes të të gjithë nxënësve. Unë do t'i mbështes këto politika dhe vlera gjatë kohës së punës vullnetare. Gjatë kohës së vullnetarizmit, unë nuk do të ndaj me nxënësit pikëpamjet e mija politike dhe personale. Nëse do të kem ndonjë pyetje rreth këtyre temave, Unë do të pyes mësuesin ose drejtorin.
- Unë do të ndaj me mësuesit dhe/ose administratorin e shkollës çdo problem që lidhet me mirëqënien e nxënësve dhe/ose sigurinë e tyre.
- Unë do të përdor vetëm banjot e përcaktuara për të rriturit.

TREGUESI 19

- Unë nuk do të mbaj me vete armë të asnjë lloji gjatë kohës që do të jem në mjediset e shkollës, ose në aktivitetet e saj jashtë mjediseve shkollore.
- Unë nuk do të mbaj ose do të tymos duhan, ose produkte që kanë në përmbajtje nikotinë dhe nuk do të mbaj, ose do të jem nën ndikimin e alkoolit, marijuanës, ose drogave ilegale në mjediset shkollore, ose gjatë aktiviteteve jashtë mjediseve shkollore.
- Unë e kuptoj, që gjatë periudhës së vullnetarizmit, Unë mund të marr dijeni për informacione private, ose sensitive ndaj nxënësve, familjeve, ose personelit. Unë jam dakord që të ruaj konfidencialitetin e këtij informacioni jashtë shkollës. Unë nuk do t'a ndaj informacionin për nxënësit, ose personelin me ndonjë njeri tjetër, dhe do të plotësoj detyrat e mia si vullnetar, siç theksohet në kodin e sjelljes.
- Unë jam dakord që të shmang shfrytëzimin, ose ndikimin e padrejtë ndaj një nxënësi, për përfshirjen e tij në një akt jo ligjor, ose imoral, ose të një sjelljeje e cila mund të jetë subjekt disiplinor për sjellje të padenjë, pavarësisht nëse nxënësi përfshihet në këtë lloj sjelljeje.
- Unë jam dakord që të mos përfshihem në ngacmime seksuale ndaj nxënësve, vullnetarëve të tjerë, ose punonjësve të shkollës. Unë do të shmang kontaktet e padenja me ndonjë nxënës, pavarësisht nëse është ose jo në mjedisin shkollor, të cilat përfshijnë të gjitha format e prekjes seksuale, marrëdhëniet seksuale, raporte romantike, ose çdo prekje e cila është e papranueshme për nxënësin, ose që është jo e duhur për një moshë të caktuar, për gjininë dhe pjekurinë e nxënësit. Unë do të jem i përmbajtur ndaj prekjes dhe përqafimit të nxënësve, edhe në rastin kur kontakti fizik nxitet nga nxënësi.
- Unë jam dakord që të njoftoj menjëherë shkollën nëse unë jam i arrestuar për kundërvajtje ose krim, si dhe shkelje që lidhen me seksin, drogën, sulmin, ose armët.

TREGUESI 20

Përbërësi tjetër në Paketën e Vullnetarit, është çertifikata e pastërtisë. Drejtoria Arsimore e Filadelfias kërkon nga të gjithë të rriturit, që dëshirojnë të jenë vullnetarë në shkollat tona, të kenë çertifikatën e pastërtisë në dosje. Kjo ka si qëllim mbajtjen sa më të sigurtë të nxënësve tanë.

TREGUESI 21

Të gjithë vullnetarët duhet të kenë tre çertifikata pastërtie:

Çertifikata e Historisë për Pastërtinë ndaj Abuzimit me Fëmijë (The Child Abuse History Clearance),
Kontrolli i Rekordeve Kriminale të Shtetit të Pensilvanisë (The Pennsylvania State Criminal Record Check),
Dhe OSE Kontrolli i Historikut nga FBI me shënjat e gishtave, OSE një Vërtetim të Firmosur të Vullnetarit.

TREGUESI 22

Të dyja çertifikatat e Pastërtisë për Abuzimin me Fëmijën dhe Kontrolli i Rekordeve të Kriminalitetit të PA, janë FALAS dhe mundësohen online. Ju mund të klikoni në linket e listuara në këtë webinar ose shkoni në www.philasd.org/face , ku do të gjeni linke për këtë qëllim.

Për marrjen e këtyre çertifikatave, ju duhet të krijoni llogarinë tuaj online, e cila do të kërkojë informacion personal të tillë; si emrin tuaj dhe informacion të kontaktit. Meqenëse ju jeni vullnetar, këto çertifikata janë FALAS! Thjesht çekoni në "volunteer" , kur të krijoni llogarinë tuaj dhe pagesa do të hiqet. Pas krijimit të llogarisë dhe të kërkesës për çertifikatë, rezultati i çertifikatës do t'ju dorëzohet në adresën tuaj të email_it.

Nëse nuk keni adresë email_i, ju mund të shkarkoni dhe printoni një kopje të çertifikatës dhe postojeni atë në shtet. Gjithmonë ju mund të takoni Koordinatorin e Përfshirjes së Familjes, ose mund të vini në Zyrën e Burimeve për Prindin dhe Familjen në adresën 440 North Broad Street dhe do të jemi të lumtur t'ju ndihmojmë.

TREGUESI 23

Së fundi, ju duhet ose të merrni një rezultat të Kontrollit të Historisë tuaj me shënjat e gishtave nga FBI, OSE të firmosni letrën e Vërtetimit të Vullnetarit.

Nëse keni jetuar në shtetin e Pensilvanisë gjatë 10 viteve të fundit pa ndërprerje, ju do të firmosni Fletën e Vërtetimit Vullnetar, në të cilën ju betoheni se keni jetuar në shtetin e Pensilvanisë për 10 vitet e fundit dhe se gjatë kësaj kohe nuk keni kryer asnjë krim federal. Fleta e Vërtetimit Vullnetar është FALAS dhe mundësohet online në: www.philasd.org/face.

Nëse NUK keni jetuar pa ndërprerje në shtetin e Pensilvanisë gjatë 10 viteve të fundit, ju duhet të kaloni Kontrollin e Historikut tuaj nga FBI dhe të plotësoni gjurmët e gishtave në një vend të caktuar (Cogent location). Shkoni në linket e listuara këtu, që të plotësoni një formular online nga ku mund të gjeni se ku janë vendet e përcaktuara. Kontrolli i Historikut nga FBI koston $24.25; Kjo është e vetmja çertifikatë e vullnetarit, e cila koston para.

TREGUESI 24

Në tërësi, të gjithë vullnetarët duhet të kenë në dosje këto çertifikata, përpara se të fillojnë vullnetarizmin në shkollë:

Çertifikata e Historisë të Pastërtisë për Abuzimin me Fëmijë (The Child Abuse History Clearance),
Kontrolli i Rekordeve Kriminale të Shtetit të Pensilvanisë (The Pennsylvania State Criminal Record Check),

Kontrolli i Historikut nga FBI, OSE një Vërtetim të firmosur të Vullnetarit.

Siç edhe e përmendëm më herët, çertifikatat tuaja do të jenë të vlefshme për 60 muaj (ose 5 vjet), kështu që ju NUK keni nevojë të merrni çertifikatë me fillimin e çdo viti shkollor.

TREGUESI 25

Ne e dimë se proçesi i marrjes së çertifikatave të pastërtisë është konfuz. Më poshtë po rradhisim pyetjet më të zakonshme dhe përgjigjet e tyre, të cilat shpresojmë të sqarojnë sa më mirë shqetësimet tuaja:

Nëse del diçka në kontrollin tuaj të pastërtisë, ju duhet të dini që Drejtoria Arsimore e Filadelfias e ka të qartë faktin, se vetëm kontrolli i historikut nuk është e vetmja vlerë që vullnetarët i ofrojnë nxënësve tanë. Kur shqyrton historikun e pastërtisë, Drejtoria Arsimore e Filadelfias, gjithashtu merr në konsideratë edhe si më poshtë:

- Sigurinë e nxënësve dhe personelit tonë.
- Natyrën dhe rëndësinë e shkeljes(ve).
- Kohën e kaluar që nga vuajtja e dënimit/vendimit.
- Natyrën e punës vullnetare, për të cilën aplikanti ka kërkuar të jetë vullnetar.
- Ndikimin pozitiv që ka individi në shoqëri, që nga koha e dënimit.

Drejtorët do të rishikojnë të gjitha dokumentat dhe do të vendosin nëse informacioni e pengon një person për punë vullnetare në shkollë. Nëse drejtorët kanë pyetje për informacionin e shprehur në dokumentat, ata do të emailin Zëvëndës Kryetarin për Marrdhëniet e Punësimit.

Çdo vullnetar i cili pengohet për vullnetarizëm në shkollë, si rrjedhojë e rezultateve në çertifikata, mund të apelojë vendimin e shkollës duke dërguar email në: parentappeals@philasd.org.

Përsa i takon individëve pa numër pune (Social Security Numbers), edhe për ta është e mundëshme për punë vullnetare. Numrat e Punës (Social Security Numbers) kërkohen vetëm për Kontrollin e Historikut nga FBI. Çertifikata e Pastërtisë për Historinë e Abuzimit me Fëmijë (The Child Abuse History Clearance) dhe Kontrolli i Rekordeve Kriminale të Shtetit të Pensilvanisë (The Pennsylvania State Criminal Record Check), nuk kërkojnë Numër Pune, po ashtu nuk kërkohet edhe nga Fleta e Vërtetimit të Vullnetarit. Kjo do të thotë, që personat pa numër pune, të tillë si ata pa dokumenta, mund të plotësojnë Çertifikatën e Pastërtisë për Historinë e Abuzimit me Fëmijë (The Child Abuse History Clearance) dhe Kontrollin e Rekordeve Kriminale të Shtetit të Pensilvanisë (The Pennsylvania State Criminal Record Check), bashkë me Vërtetimin e Vullnetarit, nëse ata kanë jetuar në Pensilvani për 10 vitet e fundit.

Nëse një individ nuk ka Numër Pune DHE nuk ka jetuar në Pensilvani për 10 vitet e fundit, është përsëri e mundur që të punojë vullnetar. Drejtoria Arsimore e Filadelfias synon të përfshijë sa më tepër familje në programin e saj të vullnetarizmit dhe prandaj, Drejtoria është fleksibël me individët që thjeshtë nuk kanë numër pune. Drejtoria i lejon individët për punë vullnetare edhe pa Kontrollin e Historikut nga FBI, nëse plotësohen konditat e mëposhtëme:

- Në dosjen e individëve është Çertifikata e Pastërtisë për Historinë e Abuzimit me Fëmijë (The Child Abuse History Clearance),

- Në dosjen e individëve është Kontrolli i Rekordeve Kriminale të Shtetit të Pensilvanisë (The Pennsylvania State Criminal Record Check),
- Individi ka si mbikëqyrës (supervisor) gjatë gjithë kohës një punonjës të Drejtorisë Arsimore.

TREGUESI 26

Në mënyrë që të jeni vullnetar në shkollat tona, është shumë e rëndësishme që të gjithë vullnetarët të kuptojnë rolin e tyre si raportues të detyruar të abuzimit me fëmijën, përfshirë se si të identifikojnë shënjat e abuzimit me fëmijën dhe çfarë të bëjë kur fëmija shfaq shënja të tilla.

TREGUESI 27

Duke filluar nga data 2 Janar 2013, Akti 126 (Act 126) kërkon që të gjithë njësitë shkollore dhe kontraktorët e pavarur të shkollave, të cilat kanë kontakt direkt me fëmijët, të plotësojnë një trajnim çdo 5 vite për njohjen e abuzimit me fëmijën dhe raportimin e detyruar. Politika Nr 906, për Abuzimin me Fëmijën e Komisionit të Reformës Shkollore, e cila është adoptuar nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias në muajin Maj 2016, cilëson që vullnetarët duhet të njohin shënjat e abuzimit me fëmijën dhe të raportojnë rastet e mundëshme të abuzimit me fëmijën.

Mbrojtja e nxënësve tanë është një përgjegjësi e ndarë, në të cilën ne presim që çdonjëri, përfshirë edhe vullnetarët të marrin pjesë.

TREGUESI 28

Bashkë me kërkesat që vullnetarët të jenë të kujdesshëm ndaj shënjave të abuzimit me fëmijët dhe proçedurat e raportimit, Politika 906 (Policy 906) kërkon gjithashtu që vullnetarët të jenë edhe "raportues të detyruar".

Raportuesve të detyruar *ju kërkohet ligjërisht* të raportojnë për dyshime abuzimi dhe pakujdesshmëri ndaj fëmijës. Të gjithë punonjësit e Drejtorisë Arsimore, kontraktorët e pavarur dhe vullnetarët janë raportues të detyruar.

TREGUESI 29

Hapi i parë në identifikimin e shënjave të abuzimit me fëmijën, është njohja e përcaktimit të termit abuzim me fëmijën.

Në formën e vet më bazike, abuzimi me fëmijën dhe pakujdesshmëria, është përcaktuar sipas ligjeve federale, si një akt veprimi, ose mosveprimi, i cili rezulton në vdekje, dëmtim serioz fizik, ose emocional, abuzim seksual, ose shfrytëzimi i një fëmije dhe një akt veprimi, ose mosveprimi, i cili paraqet një rrezik të menjëhershëm për dëmtim serioz të një fëmije.

TREGUESI 30

Sigurisht ka forma të një ndërveprimi fizik ose verbal midis një të rrituri dhe fëmijës, të cilat janë ato të duhurat. Këto përfshijnë lavdërimin e fëmijës dhe përforcimin e shprehive pozitive të punës, ose të sjelljes, rrahjen e shpatullave, mbajtjen e dorës së një fëmije të vogël, kur zbret nga autobuzi,

përqafimin e fëmijës kur fëmija ndjehet i pashqetësuar dhe kur kontakti fizik nuk është asnjëherë romantik, ose seksualisht intim.

Veprimet jo të duhura në ndërveprimin verbal dhe fizik, midis një të rrituri dhe fëmijës nuk do të tolerohen. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Komentet e degraduara, ose seksuale,
- Shakatë e rrezikëshme,
- Përkëdhelja e të ndenjurave,
- Kontakti intim, romantik, ose seksual,
- Ndëshkimi trupor, dhe
- Shfaqja, ose përfshirja e një fëmije në veprimtari pornografike.

TREGUESI 31

Ka lloje të ndryshme të abuzimit me fëmijën. Në këtë orientim ne do të trajtojmë 4 lloje prej tyre, i pari prej të cilëve është abuzimi fizik.

Abuzimi fizik është përcaktuar si një dëmtim fizik, ose vdekje e cila shkaktohet jo si rrjedhojë aksidentale. Shënjat e abuzimit fizik mund të përfshijnë ndonjë si më poshtë:

- Djegie të pashpjegueshme,
- Blana(shënja) të pashpjegueshme në faqe, buzë, gojë, kurriz, kofshë dhe në të ndenjurat,
- Dëmtime në kokë, ose të dhëmbëve,
- Kafshime nga njerëzit,
- Vizita të shpeshta në spital,
- Një fëmijë që duket i frikësuar nga prindërit, që nuk dëshiron të shkojë në shtëpi,
- Një fëmijë që frikësohet të jetë në shoqërinë e një pjestari të veçantë të personelit,
- Forca fizike e përdorur nga kujdestari i fëmijës dhe
- Një fëmijë që duket shumë i gatshëm të kënaqë të tjerët.

TREGUESI 32

Që të jemi të qartë, të gjithë prindërit nevrikosen herë-pas-here me fëmijët e tyre.

Eshtë në rregull të jesh i nevrikosur, por nuk është në rregull ti lëndosh ata kur je i nevrikosur.

TREGUESI 33

Tani le të trajtojmë një skenar të cilin mund t'a hasin vullnetarët, që bën fjalë për abuzimin e mundshëm fizik.

Është dita e parë e ngrohtë e pranverës dhe Jordyn, 10 vjeçare, ka veshur pantallona të shkurtëra. Ju vëreni që ajo ka njolla djegie lart e poshtë kofshëve të saj. Ato kanë madhësinë dhe formën e cigareve. Ju e pyesni atë që çfarë ka ndodhur me këmbët e saj dhe ajo përgjigjet "Asgjë"

TREGUESI 34

Çfarë do të thoni në këtë rast? Diçka të tillë si:

“Jordyn, kjo duket si diçka që me të vërtetë ju ka lënduar. Unë dua t’ju ndihmoj. Më trego çfarë të ka ndodhur.”

TREGUESI 35

Çfarë do të bëni më pastaj?

Telefononi në “Childline” dhe përshkruani atë që keni parë. Më vonë në këtë orientim ne do të tregojmë se si të bëhet një raportim në “Childline”.

Ju duhet gjithashtu të raportoni incidentin dhe vrojtimin edhe te drejtori juaj.

TREGUESI 36

Lloji tjetër i abuzimit me fëmijën, që do të diskutojmë, është abuzimi seksual. Abuzimi seksual përcaktohet si ndodhi, kur një i rritur përdor forcën mbi një fëmijën dhe e përfshin atë në një akt seksual, përfshirë edhe pornografinë për fëmijë, ose e detyron një fëmijë të ndjekë një akt seksual. Shënjat e abuzimit seksual mund të përfshijnë njërën si më poshtë:

- Fëmija papritur refuzon të marrë pjesë në veprimtari fizike,
- Fëmija ka vështirësi, ose dhimbje në ecje, ose kur rri ulur,
- Fëmija ka dhimbje fyti të shpeshta dhe te paspjegueshme,
- Fëmija ka shkumë, ose infeksione urinare,
- Fëmija ka çjerrje, ose gërvishtje poshtë rrobave,
- Fëmija ndërmerr kontakt seksual agresiv me një fëmijë tjetër,
- Fëmija ka njohuri, ose sjellje të pazakonshme seksuale,
- Kontakt seksual fëmijë- me -fëmijë,
- Fëmija ka shënja në brendësi të kofshëve,
- Fëmija ka frikë të rrijë vetëm me një individ të caktuar,
- Fëmija ka çrregullime të gjumit, dhe
- Ankth, nervozizëm, ose përhumje të vazhdueshme.

TREGUESI 37

Këtu po japim një tjetër skenar për vlerësimin tuaj.

Vëllai 19 vjeçar i Amelias do të vijë të marrë të motrën nga një program jashtëshkollor. Ajo ju thotë se e do vëllain e saj dhe se ata natën në dhomën e saj kanë “sekrete” .

TREGUESI 38

Çfarë do të thoni në këtë rast? Diçka të tillë si:

“Amelia, janë disa sekrete që është mirë t’i thuhen mësuesit. Ne do t’i telefonojmë disa njerëzve me të cilët është mirë të flasim.”

TREGUESI 39

Çfarë do të bëni më pastaj?

Telefononi në “Childline” dhe përshkruani atë që keni parë dhe pastaj raportoni incidentin dhe vrojtimin edhe te drejtori juaj.

TREGUESI 40

Le të shohim edhe një tjetër skenar të abuzimit potencial seksual.

Mr. Jay punon për një organizatë që menaxhon në shkollë një program jashtë shkollor.
Një fëmijë ju thote se “pee-pee e Mr. Jay është më i madh se i tij.”

TREGUESI 41

Çfarë duhet të thoni në këtë rast?

Kjo është një situatë kur është më mirë të heshtësh. Ju nuk duhet të ndikoni, ose shtrembëroni fjalët e fëmijës. Thjesht raportoni atë që keni dëgjuar.

TREGUESI 42

Çfarë do të bëni më pastaj?

Bëni një raport për “Childline” dhe spjegoni atë që keni dëgjuar. Në vazhdim ju duhet t’i raportoni drejtorit, në mënyrë që Mr. Jay mund të caktohet në detyrë tjetër, që nuk ka ndërveprim me fëmijët, ndërsa çeshtja të qartësohet.

TREGUESI 43

Forma tjetër e abuzimit me fëmijën, të cilën do t’a diskutojmë është abuzimi emocional. Abuzimi emocional përcaktohet si një model i ndërveprimit të dëmshëm midis prindit, ose kujdestarit dhe fëmijës, të tilla si kriticismi, nënvlerësimi, refuzimi, ose mosshfaqja e dashurisë, që rezultojnë në një rritje dhe zhvillim të mangët psikologjik. Shënjat e abuzimit emocional mund të përfshijnë:

- Çrregullime në të ngrënë, si anoreksia, ose ngrënia pa masë (bulimia),
- Sjelle nervoze të tilla si kafshimi i gozhdëve, larja e tepruar e duarve, ose shfaqja e një ankthi ekstrem,
- Sjellje mizore, të tilla si përdorimi i forcës fizike, ose fjalëve për të lënduar një person tjetër ose kafshë,
- Mungesë e lidhjes emocionale me prindin ose kujdestarin,
- Vonesa në zhvillimin fizik dhe emocional dhe,
- Orvajtje për vetëvrasje.

TREGUESI 44

Tani le të trajtojmë një skenar të cilin mund t’a hasin vullnetarët, që bën fjalë për abuzimin e mundshëm emocional.

Në një program pas shkollor po bëhet një mbulesë për familjen. Një djalosh 7-vjeçar- Tommy, thotë që ai nuk ka qejf të bëjë asgjë me prindërit e tij. Ai refuzon të kontribuojë në punën e përbashkët. Ekipi ka vërejtur se ai i injoroi familjarët e tij, kur ata erdhën në program.

TREGUESI 45

Çfarë do të thoni në këtë rast? Diçka të tillë si:

"Tommy, kam vënë re se jeni i mërzitur me familjen tuaj. Je mirë?"

TREGUESI 46

Çfarë do të bëni më pastaj?

Në këtë rast, ju duhet të vazhdoni vrojtimin dhe të dokumentoni atë që shikoni. Bëjini me dije personit të duhur të personelit për bisedën tuaj, kështu që edhe ata mund të vrojtojnë për shenja të keqtrajtimit.

TREGUESI 47

Forma e fundit e abuzimit me fëmijën, që do të trajtojmë është mospërfillja, ose pakujdesshmëria. Pakujdesshmëria përcaktohet si dështim i prindit, ose kujdestarit që të ofrojë nevojat bazike të fëmijës, të cilat përfshijnë ushqimin, strehimin, mbikëqyrjen, veshmbathjen, nevojat e tyre mësimore, ose ato mjekësore. Pakujdesshmëria mund të ekzistojë për shkak të refuzimit për t'ja ofruar, OSE për shkak se familja nuk ka mjetet financiare të nevojshme për fëmijën e tyre. Shënjat e pakujdesit mund të përfshijnë:

- Lypja ose vjedhja e parave për ushqim,
- Higjenë e varfër,
- Veshmbathje të papërshtatëshme, ose të pista,
- Mesatare e ulët në gjatësi dhe peshë,
- Mungesa të mëdha,
- Uri kronike,
- Marrja e përgjegjësive të të rriturve, të tilla si kujdesi për më të vegjlit në familje, ose përgatitja e ushqimit,
- Sjellje që është e ngadaltë, ose e përgjumur,
- Të qënit tepër i lodhur dhe
- Kërkesë e papërshtatëshme për vemëndje.

TREGUESI 48

Tani le t'ju marrim pak kohë për të shikuar këtë video, ku një mësues do të ndajë përvojën e tij në identifikimin e pakujdesshmërisë dhe çfarë ndodhi kur ai raportoi incidentin.

TREGUESI 49

Tani le të trajtojmë një skenar të cilin mund t'a hasin vullnetarët, që bën fjalë për një rast moskujdesi.

6-vjeçarja-Marjorie ju thotë që ajo duhet të përgatisë darkën për dy fëmijët e vegjël në shtëpi, (moshat 1 dhe 2 vjeç) kur mamaja e saj shkon në punë. Në shtëpi nuk asnjë person tjetër të rritur.

TREGUESI 50
Çfarë do të thoni në këtë rast? Diçka të tillë si:

“Uau, bëj be që është e vështirë.”

Me një fëmijë të kësaj moshe, mund të jetë më mirë të mos zhvillohet biseda më tutje. Bëni raportin dhe e lini çeshtjen në kujdesin Shërbimeve të Mbrojtjes së Fëmijëve (Child Protective Services).

TREGUESI 51

Çfarë do të bëni më pastaj?

Bëni një raport për “Childline” dhe spjegoni atë që dëgjuat. Pastaj, shikoni nëse familja ka nevojë për ndihmë për gjetjen e një kujdestareje, ose për ndërtimin e lidhjeve sociale.

TREGUESI 52

Le të trajtojmë edhe një skenari tjetër moskujdesi, meqë kjo formë e abuzimit me fëmijën është e vështirë për identifikim.

Nëna e Zach-ut nuk ka sjellë zëvëndësues për aparatin që i duhet Zach-ut. Zach_u ka astmë të rëndë dhe ka nevojë për ilaçe.

TREGUESI 53

Çfarë do të thoni në këtë rast? Diçka të tillë për nënën ose kujdestarin:

“Znj. Jones, Aparati i urgjencës i Zach-ut është bosh. Në këtë gjendje ne nuk mund t’a mbajmë atë këtu pa aparat.”

TREGUESI 54

Çfarë do të bëni më pastaj?

Sigurohuni që nëna e Zach-ut ka akses në shërbimet mjekësore të kërkuara për këtë rast. Nëse problemi përsëritet, bëni një raport për “Childline”.

TREGUESI 55

Tani le të trajtojmë se si bëhet një raport. Ndërsa trajtuam skenare të ndryshme, ne i jemi referuar shpesh herë të ashtuquajturës “Childline.” Childline është pjesë e programit shtetëror të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, i ndërtuar për marrjen e referimeve për abuzimin me fëmijët dhe në përgjithësi për çeshtje të mirëqenies së fëmijëve dhe transmetimin e menjëhershëm të informacionit te agjensitë e duhura investiguese.

Si raportues të detyruar, vullnetarët duhet të bëjnë një raportim të menjëhershëm dhe të drejtëpërdrejtë në rastet e abuzimit me fëmijët në “Childline”.

Për këtë janë 2 rrugë:

Ju mund të raportoni në mënyrë elektronike në uebsajtin e “Childline”, www.compass.state.pa.us/cwis, OSE

Ju mund ta bëni atë duke telefonuar linjën e hapur 24 orëshe të “Childline” në 1-800-932-0313.

TREGUESI 56

Tani do të shohim një tjetër video të shkurtër për të mësuar se si bëhet një raport për abuzimin me fëmijën. Mësuesja flet se pavarësisht ndjenjës së ankthit për bërjen e raportit, përparësia e saj kryesore është gjithmonë siguria e nxënësit.

TREGUESI 57

Tani do të shohim një tjetër video të shkurtër për të mësuar rreth përvojës së mësueses në bërjen e raportit, përfshirë informacionin që kërkon agjensia dhe se si ndjehet ajo gjatë kohës që përgatit raportin. Mësuesja spjegon, se si një raportuese e detyruar, ajo është ligjërisht e detyruar të bëjë një raport.

TREGUESI 58

Pas bërjes së raportit, ju duhet që menjëherë të njoftoni drejtorin, ose personin e caktuar për raportin dhe atë që keni vrejtur.

Nëse ju raportoni nëpermjet telefonit, ju gjithashtu duhet të plotësoni një raport për abuzimin e dyshuar me fëmijën —të quajtur CY-47 — dhe ta paraqitni brenda 48 orëve të raportit gojor, në agjensinë lokale për fëmijët dhe të rinjtë. Raporti CY-48 mund të gjendet online në: www.KeepKidsSafe.pa.gov, ose nga agjensia për fëmijët dhe të rinjtë.

Nëse e plotësoni raportin online, ju nuk keni nevojë të plotësoni formularin CY-47.

TREGUESI 59

Vullnetarët duhet të jenë vrojtues të shënjave që lidhen me abuzimin me fëmijët, në situata të ndryshme. Ju duhet të bën një raport për “Childline”, në rast se paraqiten këto situata :

- Ju viheni në kontakt me një fëmijë gjatë punës vullnetare (në mjedisin e shkollës dhe jashtë saj) dhe keni dyshime se fëmija është abuzuar,
- Ju jeni përgjegjës për kujdesin, mbikëqyrjen, drejtimin, ose trajnimin e fëmijës dhe keni dyshime se fëmija është abuzuar,
- Një individ ju thotë, që një fëmijë është viktimë e abuzimit, ose
- Një person 14 vjeç, ose më i madh, ju thotë që kanë kryer abuzim me fëmijë.

TREGUESI 60

Nëse një fëmijë në mirëbesim ju rrëfen se mund të jetë abuzuar me të, ju duhet të ndiqni hapat e mëposhtëm për t'ju përgjigjur fëmijës:

Dëgjojeni fëmijen.
Sigurojeni fëmijën.
Qëndroni i qetë.
Ofroni çdo ndihmë të menjëherëshme që mundni për sigurinë e fëmijës.
Mos i premtoni fëmijës se ju nuk do t'i thoni ndonjërit; nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias juve ju KERKOHET të raportoni.
Informacionin e dhënë nga fëmija mos e ndani me abuzuesit e supozuar të tij.

TREGUESI 61

Abuzimi i fëmijës nuk është kurrë bardh-e-zi- shpesh është e paqartë nëse duhet raportuar, ose jo. Një rregull i mirë është që GJITHMONE të gabosh duke mbajtur krahun e fëmijës.

Mos harroni, roli juaj i parë është të raportoni. Ju NUK jeni aty për të hetuar situatën, ose të merrni në pyetje ndonjërin; Lërini ekspertët e "Childline" të përcaktojnë çfarë ka ndodhur dhe të ndërmarrin investigimin.

Raporti juaj do të merret seriozisht dhe ju NUK do të jeni subjekt i ndonjë veprimi ndaj jush, përderisa raporti është hartuar në mirëbesim, edhe nëse pretendimet nuk rezultojnë të vërteta.

TREGUESI 62

Ne e dimë se hartimi i një raporti është i frikshëm. Asnjëri nuk dëshiron të jetë shkaktar i ndarjes së familjes. Siç edhe e patë në video më herët, bërja e raportit është shumë shqetësuese.

Por është fakt se më pak se 5% e fëmijëve që raportohen për abuzim, ose moskujdesje, janë larguar nga shtëpia dhe zakonisht jo për një kohë të gjatë. Për ata që nuk janë larguar, familjet e tyre kanë marrë shërbime, që garantojnë sigurinë e fëmijës.

TREGUESI 63

Ka rëndësi të jashtëzakonshme bërja direkte dhe e menjëherëshme e raportit për "Childline" pas dyshimit se ka ndonjë abuzim me fëmijën. Si raportues të detyruar, vullnetarët DUHET ta bëjnë vetë raportin; ata nuk mund të mbështeten për hartimin e raportit tek të tjerët — si p.sh drejtori — për ta hartuar.

Raportimi direkt dhe i menjëhershe në "Childline" zvogëlon ri-viktimizimin e fëmijës nëpërmjet organizimit të hetimit; zvogëlon traumat e panevojshme, që mund të rezultojnë nga përsëritja, pyetjet e detajuara ndaj fëmijës; rrit mundësinë e mbajtjes në përgjegjësi të kundërvajtësve; garanton që ekspertët e çeshtjes po bëjnë investigimin; dhe nxjerrin menjëherë jashtë fokusit rastet e pabazuara.

TREGUESI 64

Pasi është bërë raporti, "Childline" e çon raportin në agjensinë lokale për fëmijët dhe të rinjtë, e cila heton raportin për përcaktimin nëse akuzat mund të jenë abuzim fëmije dhe rregullon, ose ofron

shërbimet që nevojiten për parandalimin e keqtrajtimit të mëtejshëm të fëmijës dhe të ruaj unitetin e familjes. Agjensia lokale e fëmijëve dhe të rinjve duhet të fillojë investigimin brënda 24 orëve. Kryhet një hetim i plotë për të përcaktuar nëse fëmija është abuzuar dhe cilat janë shërbimet e duhura për fëmijën dhe familjen. Kjo duhet të bëhet brënda 30 ditëve, me përjashtim të rasteve kur agjensia ofron fakte pse investigimi nuk mund të kryhet gjatë kësaj kohe, përfshirë përpjekjet e bëra për marrjen e rekordeve mjekësore dhe intervistimeve të subjekteve të raportit. Nëse fajtori i supozuar në raport nuk plotëson përcaktimin e fajtorit sipas Ligjit të Shërbimeve për Mbrojtjen e Fëmijës (Child Protective Services Law), por sugjeron nevojën për hetim të mëtejshëm, "Childline" do t'a kalojë informacionin në zyrën e prokurorit përkatës.

TREGUESI 65

Si raportues i detyruar, ka dënime nëse nuk plotëson raportimin.

Raportuesit e detyruar, të cilët me dashje nuk raportojnë abuzimin me fëmijën, mund të marrin dënime të cilat radhiten nga shkelje të shkallës së dytë, në krim të shkallës së dytë.

TREGUESI 66

Ne do të përfundojmë Orientimin e Vullnetarit duke prekur disa pyetje dhe shqetësime të përgjithëshme rreth rolit të vullnetarit si raportues i detyruar për abuzimin e fëmijës.

A duhet ta dijë me siguri raportuesi i detyruar, që një fëmijë është abuzuar?

Jo. Një raportues i detyruar është përgjegjës për hartimin e raportit, kur ata dyshojnë se një fëmijë është viktimë e abuzimit.

A janë të detyruar raportuesit të bëjnë raport, kur ata mësojnë që abuzuesi është një tjetër nga ai i cili është i dyshuari i mëparshëm?

Po. Asgjë nuk i kërkon një fëmije të paraqitet para një raportuesi të detyruar, që të bëjë një raport.

A duhet që një raportues i detyruar të japë emrin e tij?

Ligji kërkon që raportuesi të identifikojë veten e tij dhe mënyrën e kontaktimit. Ky informacion është i dobishëm, nëse duhen të dhëna për qartësimin e situatës, ose informacion shtesë, në këto raste punonjësi që merret me çeshtjen mund të kontaktojë raportuesin.

TREGUESI 67

A do të bëhet i njohur identiteti i raportuesit?

Identiteti i raportuesit do të mbetet konfidencial me përjashtim të nëpunësve të zbatimit të ligjit, ose zyrës së prokurorit.

A do të dëshmojë në gjyq një raportues i detyruar?

Raporuesve mund t'ju kërkohet te dëshmojnë në një çeshtje gjyqësore civile, ose kriminale, përfshirë edhe një proçedure gjyqësore për të mitur, ose për krime.

Si e mëson raportuesi se çfarë po ndodh me raportin e hartuar dhe se çfarë po bën agjensia për mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi i mëtejshëm?

Raportuesit do të marrin informacion nga Departamenti në lidhje me statusin final të raportit, nëse ai ishte i pabazuar, nëse ka informacion, ose është i bazuar, si dhe për shërbimet e planifikuara që janë ofruar për mbrojtjen e fëmijes.

TREGUESI 68

Nëse keni ndonjë pyetje shtese, ose vërejtje, ju lutemi na kontaktoni në Zyrën e Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit me email: volunteer@philasd.org ose me telefon 215-400-4180.

TREGUESI 69

Ju faleminderit për ndjekjen virtuale të Orientimit për Vullnetarët! Ne shpresojmë që ju t'a shijoni plotësisht vullnetarizmin në shkollat tona.

Për marrjen e Çertifikatës të plotësimit të Orientimit për Vullnetar, ju lutemi klikoni linkun në ekran. Ju do të plotësoni një test të shkurtër dhe me plotësimin e tij, ju do të merrni Çertifikatën tuaj!